



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

05nr_____

Dt: 26.05.2015

Drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Komunës së Gjakovës , duke u bazuar në nenin 62.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr. 03/ L-040, nenin 45.3, 46.1 dhe 52 shkronja (a,c,i) të Statutit të Komunës së Gjakovës, me qëllim të realizimit të objektivave të strategjisë për krijimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve sa më të mira shëndetësore të nivelit primar në Komunën e Gjakovës, e miraton këtë:

V E N D I M

1. Formohet Komisioni për hartimin e raportit të gjendjes ekzistuese të objektit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare në Gjakovë , në këtë përbërje:

1. Violeta Xërxa-Thaqi, kryesuese e Komisionit
2. Xhelal Hoxha, anëtar
3. Lekë Sina, anëtar
4. Yllzim Dyla, anëtar
5. Vjollca Dujaka, anëtare

2. Komisioni i përshkruar në pikën paraprake duhet të verifikon gjendjen e objektit të QKMF-së, duke u përkujdesur që të ofron konkluzionet për plotësimin e kushteve në raport me standardet sipas kornizës ligjore në fuqi, me theks të veçantë për statikën, infrastrukturën, hapësirat e punës si dhe pozitën gjeografike të objektit.

3. Raporti i punës së Komisionit së bashku me rekomandimet për gjendjen e objektit të QKMF-së dhe zgjidhjet për sigurimin e një objekti që ofron kushte për shërbime shëndetësore sipas standardeve në fuqi, duhet të përcillet në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale.

4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

5. Vendimi iu dorëzohet:

- Anëtarëve të komisionit
- Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit
- Arkivit

Drejtori i DSHMS,

Dr. Basri Komoni